



**VENDIM**

**Nr. 138 Datë 08.10.2012**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“TUCEP” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTIRIKE NGA HEC – “TUCEP”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, nenit 19 pika 2 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, neneve 8; 9 dhe 10, pika 3, nenit 15 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.10.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TUCEP” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “TUCEP” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “TUCEP” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec – “Tucep”.
2. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës së shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k të liçensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**